



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **45**

Prishtinë, më 5.5.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Heset Cakolli, Ali Lajçi, Berat Luzha, Zef Morina, Dragiša Mirić, Munguan : Selvie Halimi, Zulfi Merxha.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Mustafë Nuhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporti i drejtorit të ZRRUM z. Afrim Lajçi,
3. Plani i Veprimt të Kuvendit të Kosovës rreth raportit të progresit nga Komisioni Evropian.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Raporti i drejtorit të ZRRUM z. Afrim Lajçi**

**Lulzim Zeneli** falënderoi drejtorin e Rregullatorit për pjesëmarrje në mbledhje dhe ftoi anëtarët e komisionit në bashkëbisedim rreth raportit të dërguar nga ky institucion.

**Naim Maloku** edhe një herë falënderoi për një raport të përgatitur mirë me shkrim për çka edhe e përgëzoi drejtorin, por para se të procedohet më tutje e shfrytëzoi rastin për disa sqarime : në faqen 23 të raportit janë shënimet për humbjet e ujërave-sa janë këto humbje dhe sa brengosëse, çka do të thotë shprehja “testet e dështuara” rreth kualitetit të ujit, për shkallën e arkëtimit a ka ndonjë masë për përmirësim (si punojnë Gjykatat rreth kësaj çështjeje), si është çmimi i ujit në krahasim me vendet e rajonit.

**Heset Cakolli** gjithashtu përsëriti vlerësimin pozitiv rreth raportit dhe pyeti për çmimin e ujit në Ferizaj (0.28 dhe 0.5 cent), si dhe arsyen pse Prishtina merr ma tepër donacione.

**Myrvete Pantina** pyeti rreth shpenzimeve kapitale, a ka investime, grumbullimi i të hyrave pse çalon edhe pas formimit të bordit dhe parashikimet për të ardhmen.

**Afrim Lajçi-drejtor** rreth pyetjeve të bëra sqaroi : për humbjet e ujërave rregullatori çdo vit përgatit raportin i cili edhe për këtë vit do të përgatitet në korrik. Humbje e ujit quhet ndryshimi i sasisë së ujit që pranohet dhe asaj që faturohet, ndaj fatkeqësisht kjo është brengosëse në Kosovë me 56% (ka edhe më keq p.sh. në Shqipëri humbjet janë 70%), arsyet janë të shumta : humbjet e mëdha, rrjeti i vjetërsuar, faktorët e jashtëm, kyçjet ilegale, mungesa e strategjisë për këtë etj të cilat do të kërkohen në periudhën e ardhshme tre vjeçare të përmirësohen p.sh. prej kompanive do të kërkohet zvogëlimi i humbjeve prej 56 në 40%. Sa i përket “testeve të dështuara” fjala është për kualitetin e ujit, analiza bëhet nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë i cili edhe monitoron rregullisht ujin, mund të thuhet se ka një trend të përmirësimit të kualitetit të ujit, sidomos sa i përket Ferizajt (bifurkacioni), ku përpara ka pasur probleme sidomos me rastin e shkrirjes së borës. Arkëtimet ose shkalla e arkëtimeve është 66% dhe direkt ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të kompanive, ka një përmirësim të vogël por punët më mirë e ka Hidromorava e Gjilanit me 77% të arkëtimit, Mitrovica i ka punët më keq pasi që është e ndarë. Kompanitë duhet të arrijnë patjetër përqindjen 80% të arkëtimit. Arsyet për shkallë të ultë janë rastet sociale, mosfunksionimi efikas i Gjykatave, problemet me minoritete etj. Shkyçjet do të përdoren në pajtim me ligjin.

**Naim Maloku** vazhdoi me pyetjen për arkëtimet në shkallë të vogël, a munden ti mbulojnë shpenzimet, përgjigja ishte negative dhe sipas drejtorit kjo paraqet shqetësim për të ardhmen. Çmimet në rajon janë të ndryshme, vazhdoi ai, sidomos në Shqipëri, në Bosnje janë tarifata më të larta, mirëpo tendenca është që tarifata mos të kalojnë më tepër se 3 apo 4 % të të hyrave mesatare të një familjeje, në Kosovë është shkuar edhe me 1%, shpresohet në përmirësime. Tarifata volumetrike janë për ujërat e zeza ndërsa fikse për ujin e pastër dhe këto dyja shkojnë bashkë me një faturë (ishte sqarim për Heset Cakollin). Për shkak se ka pasur investime dhe përmirësime të dukshme në Ferizaj, do të kërkohet nga kompania të demonstroj një menaxhim më të mirë, ngase në krahasim me kompanitë tjera ajo duhet me pas më shumë sukses. Për shpenzime kapitale tha se nuk ka pasur nevojë mirëpo kompanitë ekzistuese duhet ta funksionalizojnë me efikasitet Bordet e krijuara.

**Berat Luzha** gjithashtu përkrahu raportin dhe pyeti pse Ligji për Mbeturina lejon licencimin e deponive vetëm nga ana e MMPH ndërsa tarifata të caktohen nga Komunitat, konstatoi se çështja e licencimeve dhe punëve tjera nuk duhet të centralizohen ngase ato punë duhet ti takojnë komunave. Ka raste, shtoi ai, komuna nxjerr vendim për një kompani por nuk realizohet, gjithashtu shembull mori Hanin e Elezit e cila nuk mbulohet nga kompania regjionale (përgjigja ishte se kompania duhet të shtrij kompetencat edhe në atë komunë). Pyetja e fundit ishte pse nuk licencohen kompanitë private dhe pse ato nuk përmenden në raportin e dërguar (përmendi shembullin me një deponi në Kaçanik).

**Elheme Hetemi** pyeti pse ujësjellësit e zonave rurale nuk funksionojnë dhe sa kompetenca ka rregullatori për këtë çështje.

**Myrvete Pantina** pyeti konkretisht për ujësjellësin Mitrovicë-Vushtrri me çfarë kriteri bëhet shpërndarja e ujit.

**Afrim Lajçi** tha se duhet të eliminohen së pari paqartësitë ndërmjet Ligjit për Mbeturina dhe Rregullores së UNMIK-ut ngase kompetencat janë me konflikte ligjore, të cilat konflikte janë munduar të eliminohen me rregulloren 2006/31 (ky rregullore dekreton ligjin për mbeturina e cila ka konflikt me rregulloren nr.2004/49). Kjo zyre, tha ai, do të mundohet ti eliminoi këto probleme duke propozuar vërejtjet konkrete. Sa i përket ujësjellësve të zonave rurale ai potencoi se ato sa më tepër duhet të inkorporohen tek kompanitë regjionale, por edhe problemi përcjellës është se ato që kanë mbetur jashtë kompanive nuk janë atraktive për kompanitë (të vjetruara që kërkojnë investime). Në fund potencoi edhe një herë problemin e

mungesës së PLANIT STRATEGJIK AFATGJATË në bazë të së cilës do të vepronin kompanitë edhe rregullatori.

**Lulzim Zeneli** falënderoi dhe përmbylli diskutimin me konstatimin se kemi të bëjmë me një raport të mirë por me disa çështje brengosëse për çështjet e diskutuara në fushën e ujërave dhe të mbeturinave, sidomos sa i përket kualitetit të ujërave (shkalla e sigurisë së ujit), mungesa e strategjisë etj, ndaj në emër të komisionit propozoi :

### **P Ë R F U N D I M**

**VLERËSOHET POZITIVISHT** nga ky Komision, raporti vjetor për vitin 2008 i Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, dhe i rekomandohet Kuvendit të Kosovës ta miratoi në seancën plenare.

**KËRKOHET** nga MMPH të hartoi planin strategjik afatgjatë lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe ujërave në Kosovë.

### **3. Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës rreth raportit të progresit nga Komisioni Evropian**

**Lulzim Zeneli** tha se për këtë pikë e ka angazhuar stafin për të shkoqitur obligimet që dalin për këtë komision në fushën e veprimtarisë nga raporti i progresit të Komisionit Evropian, ndaj nga diskutimet në vijim komisioni harmonizoi qëndrimet rreth planit të veprimit të komisionit dhe nxori këtë :

### **P Ë R F U N D I M**

**MIRATOHET** në parim Plani i Veprimit dhe Përgjegjësit e këtij komisioni nga raporti i progresit të Komisionit Evropian për të përcjellë monitorimin e obligimeve që dalin nga ky plan, si vijon :

1. Pika P50 nga raporti, është i paqartë për komisionin, sidomos obligimi që i parashtrahet komisionit.
2. Pika P77 është plotësuar, ngase është miratuar ligji në fjalë.
3. Për pikën P78 kërkohet të raportoj Ministri i Bujqësisë në baza tremujore për Institutin e Verëtarisë dhe për zbatimin e ligjit për Verëra.
4. Për pikat P79, P80 dhe P81 kërkohet informatë në baza tremujore nga Ministri i Mjedisit.
5. Pikat P82 të realizohet përmes kërkesës së komisionit për themelimin e Bordit Këshillëdhënës në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.
6. Pika P85 ende nuk është e realizueshme për komisionin, ngase projektligji për siguri nukleare ende është në procedurën parlamentare.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të mbahet më 12 maj 2009 në orën 13,00.

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**